



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 65-të të mbajtur më 15.04.2022 ka miratuar sa vijon

VENDIM

Procedura në numrin e lëndës 12-615/1 të 08.02.2021, e formuar pas denoncimit për Komunën e////, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, KSHPK nuk ka elemente për veprim të metutjeshëm për arsye se ka vepruar dhe ndërmarrë masa organi tjetër kompetent.

Lënda me numër 12 - 615 të datës 08.02.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb-faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më 08.02.2021 është dorëzuar denoncim në /// dhe është themeluar lënda me numër 12-615/1 nga 08.02.2021.

Në denoncim vërehet dyshimi për mosveprim nga ana e ///, gjegjësisht mos pagesë për shpronësim të rrugës sipas aktvendimit të gjykatës, si dhe mosveprimi ndaj kërkesave për denacionalizim, pas së cilës pala nuk ka marrë përgjigje në kërkesën për të dorëzuar një dokument me shkrim - dëshmi se prona në fjalë është paguar ose dëmshpërblyer në çfarëdo baze nga pala ose paraardhësit e saj. Në denoncim po ashtu thuhet se me mos dorëzimin e kësaj dëshmie palës, pengohet e drejta ligjore në kompensim për pronën që i konfiskohet shtetit dhe nuk kompensohet në përputhje me Ligjin për denacionalizim.

Për verifikimin e pretendimeve dhe vërtetimin e plotë të gjendjes faktike në çështjen e hapur, KSHPK-ja ka paraqitur kërkesë për mbledhjen e informacionit në ///.

Nga ana e institucioneve jan dorëzuar përgjigjet me shtojcë dokumentacionin nga e cila është konstatuar si më poshtë:

- /// ka bërë pagesën e fundit te parashtruesi me datë 21.05.2021, i cili ka paguar në tërësi obligimin.

- Procedurat lidhur me kërkesat e parashtruara për denacionalizim të vitit 2003 kanë përfunduar në formë të prerë dhe janë arkivuar në njësinë përkatëse rajonale të drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Juridike, nga ku janë rifituar për veprim në mjetet e jashtëzakonshme juridike të parashtruara nga parashtruesi KSHPK-së, e cila shpalli mjete juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme në procedurë. Në momentin e dorëzimit të përgjigjes në KSHPK për njërën nga kërkesat është zhvilluar kontest administrativ në Gjykatën Administrative, ndërsa për kërkesën e dytë ka qenë në proces ankimimi në Gjykatën e Lartë Administrative.

Nga sa u tha më lartë, KSHPK vlerësoi se ka vepruar dhe ka marrë masa organi kompetent për çka nuk ka elemente për veprime të mëtutjeshme dhe ka vendosur si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Punoi: B.K.SH
Miratoi: M.r .SH.S, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHITETËROR
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Nënkryetar
Nuri Bajrami

